



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

016 5026 Prod.

It 22.12.2020

KESHILLI BASHKIAK  
V E N D I M

Nr. 157 Date .16.12.2020

PER

MIRATIMIN E NIVELIT TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Ne mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" shkronja "f" nenit 54,pika 3 neni 55; Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 për "*Sistemin e taksave vendore*" (i ndryshuar) dhe Ligjin nr.142/2015 date 17.12.2015 ...per disa ndryshime dhe shtesa.....te Ligjit 9632 date 30.10.2006, (i ndryshuar) ; ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008"*Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise*", (i ndryshuar) , Ligji nr.8438 date 28.12.1998 "*Per tatimin mbi te ardhurat i ndryshuar*", (i ndryshuar) , Ligjit Nr.115/2014 "*Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*",Ligji Nr.68/2017 "*Per financat e vetqeverisjes vendore*",pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, Këshilli Bashkiak

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat përgjegjëse per vjeljen e tyre si dhe nivelin e gjobave per kundravajtjet per vitin 2021, sipas dokumentit bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë Tropojë, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Turizmit e Sherbimeve Publike dhe e Transportit.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dit pas shpalljes dhe i shtrin efektet e tij nga data 01 Janar 2021.

SEKRETARI  
Ergent GJONGECAJ

KRYETAR KËSHILLI  
Shotë BASHAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE



BASHKIA TROPOJE

## DRAFT PAKETA FISKALE 2021

**Vizioni shkeputur nga Plani i Pergjithshem Vendore Bashkia Tropoje.**

Bashkia Tropoje e vendosur ne Shqiperine Veri-Lindore, eshte nje nga rajonet me pak te njohura te vendit. Territori i saj malore mbetet gjeresisht, I panjohur per shumicen e shqiptareve, por ka fituar vemendjen e turisteve te huaj, veçanarisht hiker-ve evropiane, qe e vizitojne rajonin per te shijuar kushtet e tij natyrore te paprekura dhe shtigjet alpine.

Mundesia per te krijuar vizionin e ardhshem eshte nje mundesi unike per te ngritur strategji, veprime dhe projekte konkrete qe e bejne Tropojen nje rajon unik, ku zhvillimi i ardhshem socio-ekonomik bazohet ne nderlidhjen e kujdesshme midis permiresimit, mbrojtjes dhe perdorimit te resurseve te saje territorial.

Vizioni per te ardhmen e Tropojes bazohet ne leximin e kujdesshem te asetave lokale te rajonit dhe ne te kujtuarit se shfrytezimi i tyre duhet te behet ne perfitimin e ekonomise dhe popullsise vendase, pa cenuar vlefshmerine dhe mundesine e perdorimit te tyre ne te ardhmen.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

PERMBAJTJA

A	Mbi Bashkinë Tropojë.....	5
A.1	Procesi i Hartimit të Paketës fiskale .....	7
A.2	Çfarë prezanton paketa fiskale .....	10
A.3	Kuadri ligjor dhe nënligjor .....	10
B	Paketa Fiskale.....	15
	Kapitulli I: Taksat vendore .....	15
I.1	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël .....	15
I.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme .....	16
I.3	Taksa e fjetjes në hotel .....	22
I.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja .....	23
I.5	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme .....	26
I.6	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura.....	27
I.7	Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare .....	27
I.8	Taksa e tabelës.....	27
I.9	<u>Taksa vendore mbi te ardhurat vetjake, taksa mbi te ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimite, testamentet ose lotarite vendore.....</u>	<u>29</u>
	Kapitulli II: Tarifat vendore.....	30
II.1	Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve, tarifa e ndricimit, gjelberimit dhe kanalizimeve .....	30
II.2	Tarifa të shërbimit administrative / Tarifa të Drejtorisë së Urbanistikes Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit.....	36
II.3	Tarifa të shërbimit veteriner .....	38
II.4	Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, dhënia e lejeve për ushtrim aktiviteti.....	39
II.5	Tarifa parkimi për mjetet e licënuara, automjeteve në vendparkime publike me pagesë .....	40
II.6	Dhënie licensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.....	41
II.7	Tarifat ne sektorin e pyjeve dhe kullotave.....	
II.8	Tarifa shërbimi nga institucione arsimit, kulture, sporti, shërbimi social etj .....	49





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

II.9 Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj.shërbimi nga institucione arsimit, kulture, sporti, shërbimi social etj .....	51
II.10 Tarifapër zënien e hapësirave publike .....	53
II.11 Tarifatë përkohshme për zënien e hapësirave publike .....	54
Kapitulli III: Gjobat .....	54
III.1 Gjobat për mosshlyerje në afat të detyrimit .....	54
III.2 Gjobat nga kontrollet dhe inspektimet tatimore.....	55
III.3 Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundravajtjet administrative.....	55
Kapitulli IV: Te ardhurat jo tatimore.....	60
IV.1 Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë .....	60
IV.2 Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime .....	60
IV.3 Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve .....	61
IV.4 Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara .....	61
IV.5 Të ardhura nga privatizimi.....	61





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

**A**                      **Mbi Bashkinë Tropojë**

Tropoja ndodhet në verilindje të Shqipërisë dhe kufizohet në veri me Malin e Zi, në jug me Rrethin e Hasit, në perëndim me Qarkun e Shkodrës (rrethin e Shkodrës dhe të Pukës) dhe në lindje me Kosovën. Secili nga këto territore ka ndërthurjen e vet të traditave, burimeve natyrore, burimeve ekonomike e cilësive infrastrukturore. Bazuar në politikat zhvillimore të territorit të Bashkisë Tropoje, veprimet tona duhet t'i japin vlerë zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së burimeve natyrore dhe traditave tona kulturore. Ndaj çështja kryesore është gjetja e mundësive që të kthejmë këtë shumëllojshmëri në avantazh konkurrues dhe çdo territor të kontribuojë në mirëqënien e Bashkisë.

Për të krijuar këtë mjedis, ne do fokusojmë punën në përdorimin efektiv të burimeve njerëzore, fizike dhe financiare.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE



Pjesa më e madhe e Tropojës përbëhet nga pjesa lindore e Alpeve të Shqipërisë. Tropoja është një zonë malore. Pjesën më të madhe të sipërfaqes e zënë malet e larta. Në këtë zonë ndodhet edhe maja e dytë më lartë në Shqipëri, Jezerca me 2693 m.

Sipas Ligjit nr 115/ 2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia Tropojë përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Bajram Curri, Fierza, Lekbibaj, Margegaj, Llugaj, Bujan, Bytyçi dhe Tropojë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Tropojës dhe qarkut të Kukësit. Bashkia ka nën administrimin e saj dy qytete (Bajram Curri dhe Fierza) dhe 68 fshatra.

Po sipas këtij ligji, Njësi Administrative të tjera, quhen zonat sipas Tabelës nr.1, të cilat ishin komuna përpara ndarjes së re territoriale.

Tabelë 1. Ndarja në Lagje dhe fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë Tropojë

Bashkia Tropojë	Qytetet dhe Fshatrat
NjA Bajram Curri	Qyteti: Bajram Curri
NjA Fierze	Qyteti: Fierze, Fshatra: Tpla, Dushaj i Poshtëm, Dege, Breg-Lumi
NjA Lekbibaj	Fshatra: Brisë, Salce, Palç, Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshe, Qerrec Mulaj, Curraj i Sipërm





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

NjA Margegaj	Fshatra: Margegaj, Fushë Lumi, Koçanaj, Shoshan, Lagja Paqës, Bradoshnicë, Dragobi, Çerem, Valbonë, Rragam
NjA Llugaj	Fshatra: Bukovë, Jaho Salih, Llugaj, Luzhë, Rrez-Mali, Rragam
NjA Bujan	Fshatra: Bujan, Rosujë, Dojan, Markaj, Gri, Lekurtaj, Selimaj, Bllatë, Gri e Re
NjA Bytyç	Fshatra: Pac, Zherkë, Vlad, Çorraj-Veliç, Berishë, Visoçë, Mash, Zogaj, Prush, Kepenek, Kam, Leniq
NjA Tropojë	Fshatra: Astë, Kojel, Viçidol, Kasaj, Gegaj, Buçaj, Papaj, Sopot, Babinë, Begaj, Shumice-Ahmetaj, Myhejan, Kovaç, Kërrnajë, Shkëlze
<b>TOTALI</b>	<b>2 Qytete dhe 68 Fshatra</b>

#### A.1 Procesi i Hartimit të Paketës fiskale

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Tropojë.

- Kabineti
- Drejtoria Ekonomike
- Sektori i Buxhetit dhe Finances
- Sektori i Tatim Taksave
- Sektori i Ndihmes Ekonomike
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit
- Sektori I Sherbimeve Publike dhe Mbeshtetese
- Sektori i Zhvillimit Rural





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

- Sektori i Mjedisit dhe Kontrollit te Territorit
- Drejtoria e Turizmit e Sherbimeve Publike dhe e Transportit
- Qendra Kulturore
- Zyra e Gjendjes Civile
- Sherbimi i Policise bashkiake
- Administratorët e njësive administrative

Hapat qe u ndoqen per hartimin e paketes fiskale jane si me poshte:







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

Ngritja e grupit te punes per hartimin e paketes fiskale te integruar

Percaktimi i bazez ligjore dhe prioriteteve strategjike te zhvillimit

Konsultimi i propozimeve te paketes fiskale me banoret ne çdo njesi administrative dhe grupet e interest,bizneset etj.

Hartimi i draftit te paketes fiskale dhe miratimi nga keshilli i bashkise

Publikimi i paketes fiskale





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

### Konsultimi me qytetarë dhe grupe interesi

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë Tropojë janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh (juridik) dhe të vogël (fizik), banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë.

### A.2 Çfarë prezanton paketa fiskale

Propozimet për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qenë në linjë dhe në zbatim të prioriteteve të strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Tropojë.

Propozimet konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, për përgatitjen e një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

#### Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

- a) Hartimin e një pakete fiskale të integruar;
- b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësia vendore duhet të arkëtojë të ardhura;
- c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent;
- d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:
  - ✓ Taksim i drejtë;
  - ✓ Tarifim mbështetur në kosto;
  - ✓ Klasifikim i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;
  - ✓ Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;

Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji;

e) Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;

f) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;

g) Aplikimi i incentivave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish të nevojë, siç parashikon ligji.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

A.3 Kuadri ligjor dhe nënligjor

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përbën ligjin bazë përreformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në Ligjin Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

- ✓ Tatimi mbi te ardhurat personale (TAP);
- ✓ Tatimi i thjeshtuar mbi BV;
- ✓ Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- ✓ Taksa e pasurisë;
- ✓ Taksa për transferimin e pasurisë së patundshme;
- ✓ Taksa për automjetet/mjetet e përdorura;
- ✓ Taksa e tabelës/reklamit;
- ✓ Taksa të përkohshme;
- ✓ Taksa vendore mbi te ardhurat vetjake, taksa mbi te ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitet, testamentet ose lotaritë kombëtare;
- ✓ Tarifa për shërbime;

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

**Ligje:**

- ✓ Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me Ligjin nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr.10354, datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt.28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015.
- ✓ Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore".
- ✓ Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ndryshuar me Ligjin nr. 9483, datë 16.2.2006, ndryshuar me Ligj Nr. 9632, datë 30.10.2006; ndryshuar meLigjin nr. 9716 datë16.04.2007; ndryshuar me Ligjin Nr. 9735 datë 17.05.2007; ndryshuar me ligj nr. 9766 datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9804 datë 13.09.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9844 datë 17.12.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9943, datë 26.6.2008; ndryshuar me Ligjin nr.10072, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr.10228,datë 4.2.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010; ndryshuar me Ligjin Nr. 20/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me Ligjin nr. 71/2012, datë 28.6.2012; ndryshuar me Ligjin Nr. 122/2012, datë 20.12.2012; ndryshuar me





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

- Ligjin Nr. 107/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 124/2013, datë 25.4.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 177/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 32/2014, datë 3.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 42/2014, datë 24.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 156/2014, date 27.11.2014.
- ✓ Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*".
  - ✓ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.
  - ✓ Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, "*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar".
  - ✓ Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, "*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*".
  - ✓ Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar me Ligjin Nr.10 065, datë 29.1.2009, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 131 dt.11.5.2009, ndryshuar me Ligjin nr. 10145, datë 28.9.2009, ndryshuar me Ligjin nr.10280, dt.20.5.2010, ndryshuar me Ligjin Nr. 10458, datë 21.7.2011, ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2012, datë 13.9.2012, ndryshuar me Ligjin Nr.120/2013, datë 18.04.2013, ndryshuar me Ligjin Nr. 178/2013, datë 28.12.2013, ndryshuar me Ligjin Nr. 86/2014, datë 17.07.2014, ndryshuar me Ligjin Nr. 157/2014, datë 27.11.2014.
  - ✓ Ligji nr. 93/2015 "*Për turizmin*".
  - ✓ Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", i ndryshuar.
  - ✓ Ligji Nr 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*".
  - ✓ Ligji Nr.10 465, datë 29.9.2011 "*Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë*".
  - ✓ Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 "*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre*", i ndryshuar.
  - ✓ Ligji. Nr. 9385, datë 4.5.2005 "*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*".
  - ✓ Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 "*Për fondin kullosor*", i ndryshuar.
  - ✓ Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Për kundravajtjet administrative*".
  - ✓ Ligji Nr.8744, datë 22.2.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*", i ndryshuar me Ligjin Nr.9561, datë 12.6.2006 dhe LigjinNr.9797, datë 23.7.2007.
  - ✓ Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*".
  - ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*", i ndryshuar.
  - ✓ Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*".
  - ✓ Ligji nr.68/2017, date 27.04.2017, "*Per Financat e Veteqeverisjes Vendore*"

**Vendime dhe udhëzime:**

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 505, datë 1.8.2007 "*Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit*".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare", i ndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 21.6.2006 "Për kriteret e transferimit dhe tëpërdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. nr. 391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave nësektorin e pyjeve dhe kullotave".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 632 datë 11.06.2009 "Për tarifat në sektorin e Kullotave".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. nr.1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 992, datë 9.12.2015 "Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", tëndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.469, datë 3.6.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 285, date 27.6.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1108, date 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave te Bashkitë, të infrastrukturës sëujtjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit".
- ✓ VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 *"Për përcaktimin e veprimtarive qëtrajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor"*.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.32, datë 31.12.2013, *"Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël"*, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, *"Për taksat kombëtare"*, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 *"Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore"*.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, datë 3.9.2015 *"Për zbatimin e vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Përpërcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apokotrata të tjera të pasurisë shtetërore"*, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, *"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"*, I ndryshuar.
- ✓ Udhëzuesi i Ministrit për Çeshtjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 *"Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 dat.30.12.2015 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme"*.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

**B** Paketa Fiskale

**Kapitulli I: Taksat vendore**

Ky kapitull trajton taksat vendore duke u nisur nga elementët:

- Lloji, niveli i taksës, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

**I.1 Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël**

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 14 000 000 (tetë milionë) lekë, nuk i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, pra shkalla e tatimit mbi fitimin është 0% (Ligji Nr. 106/2020 Per disa ndryshime ne Ligjin nr.8438, date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat" te ndryshuar).

**Baza e taksës/tatimi:** Pra, nuk do të ketë Këste të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor deri në 14 (katërmbëdhjetë) milionë lekë, që në vitet e mëparshme llogariteshin në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

**Niveli i tatimit:** Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqiten si më poshtë:

*Tabelë 2. Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

I.1	Shkalla tatimore	Njesia	Niveli Ligjor/Detyrimi	
			NjA B.Curri	NjA te tjera
A	Me qarkullim vjetor nga 0 – 14.000.000 lekë	lekë/vit	0% e fitimit	0% e fitimit

### I.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendasose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi truallin

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

#### I.2.1 Taksa mbi ndërtesat

**Baza e taksës:** Është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhenën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Dokumentat që vërtetojnë pronësinë janë: Çertifikata e Pronësisë, Vendimi i Komisionit të Kthimit Pronave, Vendimi i Privatizimit etj.dokumenta, conform legjislacionit në fuqi.

**Niveli i taksës mbi ndërtesat:** Niveli për kategoritë dhe nënkategoritë, nivelet treguese të taksës mbi ndërtesën prezantohen si më poshtë vijon.

Në kategorinë I.2.1 “Ndërtesa Banimi”, përfshihen:







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

- Të gjitha hapësirat që përdoren për qëllim jofitimprurës nga qytetarët vetëm për qëllim banimi.
- Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi.
- Ndërtesa të dyta banimi.

Në kategorinë I.2.2 “Ndërtesa të tjera”, përfshihen:

a) “Ndërtesa për tregti dhe shërbime”

- *Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj të ngjashme me to:* Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat, hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familje, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, banka, zyra, farmaci, klinika, spitale, maternitete, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve, stadione, komplekse sportive si palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura dhe njësi tregtare dhe shërbimi të çdo lloji etj. Të ngjashme me to.

- *Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesë biznesi.*

b) “Të tjera”: Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat të cilat nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme:

- *Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve:* do të përfshihen pronat të cilat përdoren nga organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasadat të njohura ose të regjistruara si të tilla në gjykatë.

- *Ndërtesa për aktivitete artizanale, profesione të lira, qendra social kulturore, arsimore e shkencore:* do të kuptojmë të gjitha ndërtesat njësitë e shërbimit artizanal si marangoz, këpucar, orëndreqës, berber, ondulacion, fotograf, biçiklist etj (të ngjashme me to), profesione si: avokat, noter, kontabilistë, dentist, farmacist, piktor, disanier, aktevitete sishkollat, kopshtet, çerdhet, qendrat kulturore, qendrat sociale, ndërtesat shkencore si institute kërkimore, qendra kërkimore, sallat e koncerteve, etj.

- *Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet:* do të kuptojmë të gjithë objektet të cilat janë kapital i ndërmarrjeve shtetërore dhe kanë qenë kapital i ish-ndërmarrjeve shtetërore:

- Kur është objekt i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese të cilat janë tërësisht të amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pavarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.
- Kur ka qenë objekt i ish-ndërmarrjeve shtetërore të cilat janë privatizuar (tërësisht ose pjesërisht ndërmarrja ose vetë objekti) dhe është tërësisht i amortizuar (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pavarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.

c) “Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese”





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

- "Ndërtesa prodhimi" do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, furrë buke, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, naftë etj., shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve tregtare, taksa e pasurisë përlllogarit dhe paguhet si I.2.2 "Ndërtesa të Tjera", sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë duke u përjashtuar nga Kategoria I.2.1 "Ndërtesa banimi".

Në kategorinë I.2.3 "Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike", përfshihen të gjithë taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike.

Tabelë 3. Taksa mbi ndërtesat

Emertimi I kategorise	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore	
		Për të gjitha NjA	
		Sipas Ligjit	Miratuar
Ndertesat qe perdoret, shfrytezohet per banim	Shkalla e Takses	0.05%	0.05%
Ndertesat qe perdoret shfrytezohet per veprimtari ekonomike	Shkalla e Takses	0.2%	0.2%
Per te gjithë siperfaqen ndertimore per te cilen ndertuesi është i paisur me leje ndertimore per te cilen ndertuesi nuk ka arritur te perfundoje sipas afatit te percaktuar ne aktin e lejes se ndertimit.	Shkalla e Takses	30%	30%

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Sektori i Tatim/Taksave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

**Përfashtime:** Përfashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetëror
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
- ë) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:**

Detyrimi për vjeljen e takse për familjarët shlyhet në bazë vjetore nga Njesite Administrative perkatëse.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetdeklarimit të sipërfaqes së ndërtesës, aplikohet detyrimi vjetor referues i taksës së ndërtesës për familjet.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetdeklarimit të sipërfaqes së ndërtesës, detyrimi vjetor referues i taksës së ndërtesës për familjet llogaritet për një sipërfaqe prej 70 m<sup>2</sup> për njesinë administrative Bajram Curri, dhe 100 m<sup>2</sup> për Njesite Administrative të tjera.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Sektori i Tatim/Taksave vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, brenda datës 20 prill të vitit fiskal.

**Metodologjia e llogaritjes së taksës:**

1. Përcaktimin e çmimit vlerësues të ndërtesave, për efekt të vlerësimit të vlerës së taksueshme ndërtesë për vitin ushtrimor 2019, si më poshtë:

1.1 Ndërtesa banimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE**

i. Çmimi mesatar vlerësues për metër katror ( $m^2$ ) për njësinë administrative Bajram Curri është **27 900 lekë/ $m^2$** , siç përcaktohet në Aneksin 1 të VKM nr.132/2018 për qytetin Bajram Curri.

ii. Çmimi mesatar referues për 1 (një) metër katror ( $m^2$ ) për njësite e tjera administrative, reduktohet në masën 35 (tridhjetë e pesë) për qind, sipas të drejtës që njih shkronja “dh” në Aneksin 2 të VKM nr.132/2018, referuar çmimit mesatar vlerësues të përcaktuar në Aneksin 1 për qytetin Bajram Curri.

Çmimi mesatar referues për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtesat e destinuar për banim, për këto njësi administrative bëhet:

$$27\,900 \text{ lekë}/m^2 - (27\,900 \times 35\%) = 18\,135 \text{ lekë}/m^2$$

iii. Përrjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës të gjitha llojet e ndërtimeve të parashikuara në pikën 6 të nenit 22, të Ligjit nr. 9632/2006 të ndryshuar.

1.2 Ndërtesa që përdoren për veprimtari ekonomike:

a) Ndërtesa që përdoren për veprimtari tregtimi dhe shërbimi, çmimi mesatar vlerësues në:

a.1. Njesia administrative Bajram Curri, bëhet  $27\,900 \text{ lekë}/m^2 \times 1.5 = 41\,850 \text{ lekë}/m^2$ .

ii. Për njësitë administrative Fierze, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj, Bujan, Tropoje  $18\,135 \text{ lekë}/m^2 \times 1.5 = 27\,202.50 \text{ leke}/m^2$  ( $(27\,900 \text{ lekë}/m^2 - (27\,900 \times 35\%)) = 18\,135 \text{ lekë}/m^2$ )

b) Çmimi mesatar vlerësues për kategorinë parkingje të mbuluara dhe bodrume në ;

b.1. Njesia administrative Bajram Curri bëhet:  $27\,900 \times 70\% = 19\,530 \text{ lekë}/m^2$ .

b.2. Për njësitë administrative Fierze, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj, Bujan, Tropoje  $18\,135 \text{ lekë}/m^2 \times 70\% = 12\,694.50 \text{ leke}/m^2$

c) Çmimi mesatar referues për kategorinë parkingje të hapura ne;

c.1. Njesia administrative Bajram Curri bëhet:  $27\,900 \times 30\% = 8\,370 \text{ lekë}/m^2$ .

c.2. Për njësitë administrative Fierze, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj, Bujan, Tropoje  $18\,135 \text{ lekë}/m^2 \times 30\% = 5\,440.50 \text{ leke}/m^2$

ç) Çmimi mesatar referues për ndërtesat e destinuar për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industrial, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, në:

ç.1. Njesia administrative Bajram Curri bëhet:  $27\,900 \times 50\% = 13\,950 \text{ lekë}/m^2$ .

ç.2. Për njësitë administrative Fierze, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj, Bujan, Tropoje  $18\,135 \text{ lekë}/m^2 \times 50\% = 9\,067.50 \text{ leke}/m^2$

d) Çmimi për  $m^2$  sipërfaqe që përdoret për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale:

d.1. Njesia administrative Bajram Curri bëhet:  $27\,900 \text{ lekë}/m^2 \times 30\% = 8\,370 \text{ lekë}/m^2$





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

d.2. Për njësitë administrative Fierze, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj, Bujan, Tropoje bëhet:  $18\ 135 \text{ lekë m}^2 \times 30\ \% = 5\ 440,50 \text{ lekë/m}^2$ .

1.3 Për kategorinë e ndërtesave të destinuara për banim, të cilat janë privatizuar me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, vetëm për rastin e shitjes së parë, çmimi mesatar referues përcaktohet përkatësisht:

i. Për njësinë administrative Bajram Curri bëhet:  $27\ 900 \times 70\ \% = 19\ 530 \text{ lekë/m}^2$ .

ii. Për njësitë e tjera administrative të Bashkisë Tropojë bëhet:  $18\ 135 \times 70\ \% = 12\ 694 \text{ lekë/m}^2$ .

**Marrreveshje:** Me përjashtim të rasteve kur në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" përcaktohet shprehimisht ndryshe, Bashkia Tropoje t'iu krijojë mundësi subjekteve taksapagues, të bëjnë pagesen e taksave dhe tarifave vendore me keste, me marreveshje midis paleve dhe për ato subjekte që paguajnë brenda 31 Marsit ka zbritje prej 15%.

### 1.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

**Përkufizimi:** "Tokë bujqësore" është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

**Baza e taksës:** Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Tabelë 4. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore

Kategoritë mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore	
		Për të gjitha NjA	
		Sipas Ligjit	Miratuar
I	Lekë/ha/vit	0	0





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

II	Lekë/ha/vit	0	0
III	Lekë/ha/vit	0	0
IV	Lekë/ha/vit	0	0
V	Lekë/ha/vit	900	630
VI	Lekë/ha/vit	800	560
VII-X	Lekë/ha/vit	700	490

**Detyrimi për pagesë:** Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet për subjektet e biznesit nga Sektori i Taksave/Tarifave dhe për familjarët shlyhet në bazë vjetore dhe mblihet nga administratoret në çdo njësi administrative.

**Përjashtime:** Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:** Struktura e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore, për të gjitha kategoritë, janë Njesite Administrative.

Ngarkohet Sektori i Bujqësisë, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë.

Ngarkohet sektori i AMTP – ve pranë Bashkisë për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme ia përcjell këtë informacion Sektorit të Taksave/Tarifave për llogaritjen e detyrimit.

**Marrreveshje:** Me përjashtimtë të rasteve kur në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” përcaktohet shprehimisht ndryshe, Bashkia Tropoje t’iu krijojë mundësi subjekteve taksapagues, të bëjnë pagesen e taksave dhe tarifave vendore me keste, me marrreveshje midis paleve.

### *1.2.3 Taksa mbi truallin*

